



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 56.
Prishtinë, më 7.12.2012 në ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Jasmina Živkovic, Petar Miletic, Mufera Sinik, Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Glauk Konjufca, Xhevdet Neziraj dhe Jelena Bontic.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues i OSB-së Lejla Selimi, përfaqësuese i Sekretariatit të KKK Zijush Ahmeti, përfaqësuesit e Ambasadës Zvicerane Norbert Ruetsche, Sakibe Jashari, përfaqësues nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut Kosovë Besart Lumi, përfaqësues i zyrës së Presidencës (ZPRK) Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Ilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinate - Natasa Prica-Tisma, zyrtare e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Goran Marinkovic**, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
3. Shqyrtimi i raportit nga vizita e Komisionit, në Kuvendin Komunal të Mitrovicës;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për procedurën Përmbartimore me raportin e komisionit Funkcional për Legjislacion, me amendamente;
5. Shqyrtimi i Projekt Kodit të Procedurës Penale, me raportin e komisionit Funkcional për Legjislacion, me amendamente;
6. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Danush Ademi;
7. Të ndryshme.

Kryesuesi – konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – propozoi që rendi i ditës të plotësohet me pikën; shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-165 , Për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Petar Miletic- ishte i mendimit që shqyrtimi i këtij projektligji të radhitet në pikën e katërt të rendit të ditës.

Pasi nuk kishte propozime tjera, Komisioni e miratoi rendin e ditës, me këtë plotësim ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar.

Kryesuesi - konstatoi se komisioni, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtura më 20.11.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit nga vizita e Komisionit, në Kuvendin Komunal të Mitrovicës;

Kryesuesi - konstatoi se në takimin e Kuvendit Komunal të Mitrovicës, prezent ishin edhe zëvendëskryesuesi me bashkëpunëtorët e tij, të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

Pasi nuk kishte vërejtje tjera Komisioni miratoi Raportin e vizitës në Kuvendin Komunal të Mitrovicës, me propozimin e lartcekur.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04L/165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, me raportin e komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04L/165 për **Buxhetin e Republikës së Kosovës**, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohet Komisionit FunkSIONAL.

Petar Miletic dhe **Elmi Reçica**, propozuan që komisioni, gjatë shqyrtimit të Projektligjit nr. 04L/165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës dhe të Projektligjit për procedurën Përmbartimore të deklarohet për votim, vetëm për amendamentet e komisionit funksional.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. A) Komisioni ka shqyrtuar amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, dhe të njëjtat i miratoi në tërësi.

B) b.1 Komisioni shqyrtoi propozim Amendamentin 43, të deputetes Alma Lama dhe Amendamentin 48 të deputetit Hydajet Hyseni, dhe se të njëjtat nuk i miratoi.

b.2 Komisioni shqyrtoi Amendamentet e deputetit Njazi Idrizi dhe të njëjtat nuk i miratoi, përveç amendamentin 46.

III. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional dhe propozim amendamentet e Komisionit për Komunitete dhe Kthim, mund të procedohen për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për procedurën Përmbartimore , me raportin e komisionit Funkcional për Legjislacion, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04L/165 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoj që komisioni të deklarohej nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohet Komisionit Funkcional.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për procedurën Përmbartimore dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. A) Komisioni ka shqyrtuar amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, dhe të njëjtat i miratoi në tërësi.
B) Propozim Amendamenti 6, të deputetes Albulena Lama, Komisioni nuk e miratoi.
- III. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projekt Kodit të Procedurës Penale, me raportin e komisionit Funkcional për Legjislacion, me amendamente.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në **Projekt Kodit të Procedurës Penale**, dhe konstatoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Meqë nuk kishte vërejtje, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projekt Kodit të Procedurës Penale dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Danush Ademi;

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nuk e shqyrtoi kërkesën e deputetit Danush Ademi, nga se të njëjtën çështje e ka ngritur Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Kjo çështje është përfshirë në raportin të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, në amendamentin 25, me tekstin si në vijim:

Nënprogrami i Skemës së Asistencës Sociale, shtohet projekt i ri ‘ ndërtimi i shtëpive për Komunitetin Ashkali në fshatin e Dubravë të Komunës së Ferizajit, në vlerë prej 450,000 euro.

8. Të ndryshme.

Kryesuesi – i njoftoi anëtarët se në këtë takim janë prezent sekretari i parë i zyrës së Ambasadës Zvicerane Norbert Ruetsche dhe përfaqësuesja Sakibe Jashari, që të diskutohet lidhur me çështjen e ditës ndërkombëtare të të drejtave njeriut. Njëherit falënderoi Ambasadën Zvicrane për përkrahjen dhe mbështetjen e përhershme që i ofron komisionit tonë.

Norbert Ruetsche , me theks të veçantë tha se me datën 10.12.2012, do të shënohet dita e të drejtave të njeriut. Ai prezantoi punën e Nismës së të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (YIHR KS) e cila është mbështetur nga Ambasada Zvicrëane, zyra në Kosovë.

Nisma e të Rinjëve ka organizuar një tryezë të rrumbullakët dhe njëherit ftohen anëtarët e komisionit që të marrin pjesë në këtë tryezë, me temën: Mbrojtja dhe Përfaqësimi i të Drejtave për të Gjithë Personat nëpërmjet Kuvendit të Kosovës, e cila do të mbahet në Swiss Diamond Hotel, Prishtina.

Me këtë ngjarje do të diskutohet për përfaqësimin dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut ku do të ketë bashkëpunimin edhe me akterë të ndryshëm, përfshirë edhe organizatat e shoqërisë civile.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic